



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:204437
Datë: 19.09.2022
Numri i dokumentit: 03435660

C.nr. 1382/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gllgjani dhe bashkëpunëtoren profesionale Gresa Sadiku, në çështjen juridike të paditëses A.Zh nga Gjakova, përfaqësuar nga Ilir Rogova avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale Arsimit, kontest pune - kompensim të diferencës në paga mujore, vlera kontestit 1,439.10 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 08 shtator 2022, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurës, përpiluar më 19 shtator 2022, murr këtë:

A K T G J Y K I M

DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës- Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses A.Zh nga Gjakova, në emër të diferencës së shtesës së kualifikimit në paga mujore, që nga data 01 tetor 2018 deri me 31 dhjetor 2020 për gjithsejtë 26 paga mujore të realizuara të ia kompensoi shumë prej 1439.10 (njëmijë e katërqind e tridhjetë e nëntë euro e dhjetë cent) pra 27% të pagës bazë në lartësi prej 55.35 euro për 26 muaj duke llogaritur edhe kamatën ligjore 8% në nivel vjetor e cila rrjedh nga data 08 shtator 2022 e deri në pagesën definitive, si dhe të ia kompensoi shpenzimet procedurale në shumë të tërësishme prej 394.40 (treqind e nëntëdhjetë e katër euro e dyzet cent), e që krejt këto të ia paguaj në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me padi dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar se është në marrëdhënie pune te e paditura dhe atë pa ndërprerje prej 18 vitesh në shkollën "Emin Duraku" në Gjakovë, si mësimdhënëse e mësimit lëndor. Paditësja është anëtare dhe paguan anëtarësi mujore në sindikatën e arsimit "SBASHK". Sa i përket shkollimit paditësja ka përfunduar Fakultetin e Edukimit – Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në vitin... Duke u bazuar në nenin 33 të Ligji për Arsim Parauniversitar, paditësja është licencuar me Licencë të Karrierës. Kjo licencë sipas ligjit, është lëshuar me..., e për kohështrirje pesëvjeçare dhe atë, deri më 26 dhjetor 2017. Me nenin 33 paragrafi 1.1 dhe sipas Udhëzimit Administrativ UA.05/2017 të MASHT, është përcaktuar se: "Vazhdoen për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014. Licencat e lëshuara në këto vite mbeten të vlefshme deri në periudhën e realizimit të Vlerësimit Profesional të Mësimdhënësve (VPM)". Me këtë dispozite, licenca e paditëses e

lëshuar në vitin 2012, e cila ka skaduar në vitin 2017, ex lege është vazhduar edhe për pesë vite, pra deri në dhjetor të vitit 2022. Deri te ky vazhdim i periudhës së licencimit ka ardhur si rezultat i ngecjes së procedurës së "VPM". Nuk është kontestues fakti që paditësja nuk i është nënshtruar procedurës së Vlerësimit Profesional të Mësimdhënësit, prandaj licenca e mësimdhënësies e prezantuar si më sipër, vazhdon të prodhojë efekte juridike deri më... Ngecja e procedurës së "VPM", pos që nuk është përgjegjësi e paditëses, nuk ka asnjë relevancë në këtë kontest lëndor, sepse siç u tha licenca është vazhduar ex lege.

Paga bazë e paditëses, sipas gradës "A", që nga janari i vitit 2015 e deri në dhjetor 2020, ka qenë si vijon: 2015: grada A, paga bazë prej 405.00 euro; 2016: grada A, paga bazë prej 405.00 euro; 2017: grada A, paga bazë prej 405.00 euro; 2018: grada A, paga bazë prej 421.00 euro; 2019: grada A, paga bazë prej 421.00 euro; 2020: grada A, paga bazë prej 421.00 euro.

Për ta ndërtuar pagën bruto të paditëses, atëherë si shembull mund të referohemi vetëm listës së pagave për të mbledhur shënimet nga aty: "Paga bazë (grada A)-421.00 euro, kësaj shume i shtohet kualifikimi për fakultet në shumën prej 58.32 euro, kësaj shume i shtohet shuma prej 35.80 euro në emër të 18 viteve përvojë pune, si dhe shuma e përgjithshme të pagës bruto në lartësi prej 515.32 euro".

Për ta ndërtuar pagën neto të paditëses, atëherë i referohemi sërish listës së pagave maj 2020: "Nga paga bruto 515.32 euro, zbritet kontributi pensional në lartësi prej 25.77 euro, shumës së mbetur i zbritet edhe tatimi në burim në lartësi prej 26.76 euro, e më pas ia heqim edhe shumën prej 2.31 euro, e cila paguhet për anëtarësi në sindikate, dhe si përfundim paga neto e paditëses mbetet shuma prej 460.48 euro.

Rubrika e paditëses në secilën listë të pagave për qëllim të këtij kontesti përmban titullin e punës, grada "A", shtesa për kualifikim Fakultet, pagesa për anëtarësi në Sindikatë. E paditura duke u bazuar në dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit i ka paguar paditëses shtesat mujore në pagën bazë dhe atë e ka bërë duke u bazuar në dy kritere në bazë të kualifikimit për fakultet (këtë e ka bërë pjesërisht) si dhe në bazë të viteve të përvojës së punës.

Objekti i këtij kontesti lëndor ka të bëjë pikërisht në shtesat në bazë të kualifikimit e që kjo ka ndikuar drejtë për drejtë në pagën e paditëses. Duke ju referuar listës së pagave për secilin vit për periudhën e kërkesës padisë atëherë kemi ; gjatë viteve 2015, 2016, dhe 2017 paga bazë ka qenë 405.00 ndërsa për vitet 2018, 2019 dhe 2020 paga bazë ka qenë në shumë prej 421.00; shtesa për kualifikim me fakultet 58.32 euro.

Fakti se paditësja ka realizuar pagën bazë si më sipër dhe ka pranuar shtesë si më sipër nuk është kontestues. Kontestues nuk është as fakti se është rritur paga bazë nga 405.00 euro në 421.00 euro. Kontestuese është lartësia e shtesave për kualifikim me fakultet. Kontrata Kolektive për Arsimin Para universitar e datës 14 prill 2014 e cila a filluar së zbatuar me 01 janar 2015 me nenin 7 ka normuar " Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit në fuqi". Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna dhe atë : "1.3 mësimdhënës me diplomë fakultetit 27% e pagës bazë". E drejtë e të njëjtës në lartësi të njëjtë prej 27% të pagës bazë është vazhduar edhe me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18 prill 2017, kontratë e cila ka prodhuar efekte për një periudhë kohore 3 vjeçare,

e që e njëjta sipas nenit 45 të saj ka vazhduar së zbatuari edhe për një vit deri në janar të vitit 2021 sepse palët nuk janë tërhequr nga kjo kontratë. Si përfundim kërkesëpadia e paditëses, që nga janari 2015 e deri në dhjetor 2020, bazohet pikërisht në Kontratën kolektive të vitit 2015 dhe 2017. Në rastin konkret, që nga janari 2015 e deri në dhjetor 2017, e paditura ka qenë e obliguar që paditëses të ia paguaj shtesën mujore në lartësi 109.35 euro në muaj. Më pas, që nga janari 2018 e deri në dhjetor 2020, e paditura ka qenë e obliguar që paditëses të ia paguaj shtesën mujore në lartësi prej 113.67 euro. Obligimi në kuptim të këtyre shumave, buron duke e llogaritur pagën bazë (405.00 euro, apo 421.00 euro), si dhe kësaj shume ka qenë dashur ti shtohet shtesa në lartësi 27% të pagës bazë, sipas nenit 7 "Licencimi" të të dy kontratave kolektive. Tutje ndër vite ka pasur ndryshim të pagës bazë, e po ashtu ka ndryshuar edhe lartësia e shtesës në të ardhura.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet pranë padisë, objekt i këtij kontesti ka të bëjë me kompensimin e diferencës në pagën mujore në saje të kualifikimit dhe licencimit të paditëses, obligim ky që për të paditurën rezulton nga kontrata kolektive. E paditura ka ushtruar përgjigje në padi mirëpo nuk e ka kundërshtuar asnjë pretendim të paditëses e madje as nuk ka ofruar prova materiale me të cilën eventualisht do të mund ti kundërshtonte pretendimet e këtij paditëses. Prandaj deklaroi se faktet e shtjelluar në referat të padisë nuk janë kontestuese në mes të ndërgjyqësve. Megjithatë e paditura është thirrur në parashkrim për çka në kuptim të nenit 261 të LPK-së paditësja bënë tërheqjen e padisë për pjesën e parashkruar dhe atë që nga data 01 janar 2015 e deri më 14 nëntor 2018, ashtu që padia e paraqitur do të konsiderohet sikur mos të ishte paraqitur fare. Megjithatë ka deklaruar se që nga data 15 shtator 2018 e deri më 31 dhjetor 2020 paga bazë e paditëses si dhe pagesat e përsëritshme të shtesave nga e paditura është fikse vlerëson që në këtë çështje kontestimore nuk ka nevojë për ekspertizë financiare dhe paditësja drejtpërdrejtë e precizon kërkesëpadinë ashtu që: nga 01 tetori 2018 e deri më 31 dhjetor 2020 paditësja ka realizuar 26 paga mujore dhe për këtë për secilin muaj ashtu siç është elaboruar në referat të padisë e paditura për secilin muaj ka mbetur borxh paditëses në shumë mujore prej 55.35 euro mujore, kjo pra në emër të shtesës në pagë prej 27% në pagën bazë (421.00) euro dhe rrjedhimisht paditësja e precizon padinë në aspektin objektiv duke e kërkuar shumën e përgjithshme prej 1,439.10 euro pra 27% të pagës bazë në lartësi prej 55.35 euro për 26 muaj për periudhën prej 01 tetor 2018 e deri më 31 dhjetor 2020 me kamate ligjore 8% në nivel vjetor e cila rrjedh nga data 14 shtator 2021 e deri në pagesë definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar baza juridike e padisë dhe lartësia e të njëjtës sipas theksimeve të bëra ashtu që gjykatës i propozoi që të njëjtën të aprovoi në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i kërkoi sipas TA , për taksë gjyqësore, përpilim të padisë dhe përfaqësim në seancë.

E paditura ka parashtruar përgjigje në padi me datë 23 qershor 2022 dhe ka deklaruar se: bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar në mes të MASHT me datë 22 janar 2021 në nenin 47 të saj ka shfuqizuar Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë në mes MASHT dhe SBASHK numër 01B/2056 datë 18 prill 2017 ashtu që në nenin 7 të Kontratës Kolektive citim " Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë

dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës dhe mbi bazë e licencës së fituar” bazuar në Udhëzimin administrativ numër 5/2017. Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale si vijon: mësimdhënës me licencë të karrierës 10% e pagës bazë, mësimdhënës me licencë mentor 15% e pagës bazë, por lidhur me këtë dispozitat kalimtare të paraparë me nenin 45 paragrafi 1 citim: “ MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave angazhohen bashkërisht për të informuar dhe ndihmuar komunitat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostove financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafi 5,7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në Buxhetin e Republikës së Kosovës por jo me vonë se viti 2023, sipas Qarkores buxhetore 22/01 të datës 14 maj 2021 të lëshuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe e paditura ka deklaruar se thirrëmi në parashkrim ku sipas nenit 87 të Ligjit numër 03/L-2012 të punës “ Të gjitha kërkesat nga marrëdhënie e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës” (14 shtator 2021, 14 shtator 2020, 14 shtator 2019, 14 shtator 2018) dhe ka propozuar që të refuzohet kërkesa e paditëses si e pabazuar. Shqyrtimin përgatitor-kryesor i caktuar me datë 08 shtator 2022, Gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses, sipas nenit 409.2 dhe 423.4 të LPK-së e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave: kontrata e punës e datës... Leg nr... datë... (fotokopje), Diploma e Fakultetit të Edukimit nr... e datës..., Leg nr... datë..., Licenca e mësimdhënësit nr... e datës..., listat e pagave për muajin maj 2018, 2019 dhe 2020, pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 02 janar 2015 deri me 02 korrik 2021, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditëses është e bazuar dhe u aprovua.

Nga Kontrata e punës e datës... vërtetohet se paditësja në cilësinë e mësimdhënësës të lëndës Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në shkollën “Emin Duraku” Gjakovë, me kualifikimin bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe – Fakulteti i Edukimit me 240 ECTS ka lidhur kontratë të përhershme të punës. Paditësja posedon Diplomë të nivelit të parë në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Ministria e Arsimit dhe Shkencës Universiteti” Hasan Prishtina” - Prishtinë e diplomuar me... Paditësja posedon licencën e mësimdhënësës me numër... e lëshuar datë... deri më datë..., me të cilën vërtetohet se paditësja është licencuar për periudhe pesë vjeçare. Nga lista e pagave e muajin maj 2018, vërtetohet se paditësja A.Zh është në cilësi të mësimdhënësës në shkollën fillore me kualifikimin fakultet, realizon pagën bruto në shumë prej 509.90 euro, për kualifikim fakultet realizon shtesën 58.32 euro, paguan për pensionim 25.50 euro, tatimi në të ardhura 26.24 euro, ka pesëmbëdhjetë vite përvojë pune, është anëtare e SBASHK paguan anëtarësi (0.5%) në shumë prej 2.29 euro, pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto 455.87 euro. Nga lista e pagave për muajin maj 2019, vërtetohet se paditësja është në cilësi të mësimdhënësës në shkollën fillore me kualifikimin fakultet, realizon pagën bruto në shumë prej 513.22 euro, për kualifikim fakultet realizon shtesën 58.32 euro, paguan për pensionim 25.66 euro, tatimi në të ardhura 26.56 euro, ka shtatëmbëdhjetë vite përvojë pune, është anëtare e SBASHK paguan anëtarësi (0.5%) në shumë prej 2.31 euro, pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto 458.69 euro. Nga lista e pagave për muajin maj 2020, vërtetohet se paditësja është në cilësi të mësimdhënësës në shkollën fillore me kualifikimin fakultet, realizon pagën bruto në shumë prej 515.32 euro, për kualifikim fakultet realizon shtesën 58.32 euro, paguan për pensionim 25.77 euro, tatimi në të ardhura 26.76 euro, ka

tetëmbëdhjetë vite përvojë pune, është anëtare e SBASHK paguan anëtarësi (0.5%) në shumë prej 2.31 euro, pagën neto e ka me gradën "A"-421 dhe realizon pagën neto 460.48 euro. Nga pasqyra e llogarisë së trustit pensional e datës 07 korrik 2021, vërtetohet se paditësja ka të deklaruar kontribut pensional prej periudhës 2 janar 2015 e deri në 02 korrik 2021.

Lidhur me kompensimin gjegjësisht diferencën e kompensimit në paga mujore që ka realizuar paditësja Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 7 pika 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18 prill 2017 sipas të cilës dispozitë përcaktohet se: "Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë pika 1.3 mësimdhënës me diplomë fakultet 3 dhe 4 vjeçare 27% të pagës bazë, andaj bazuar dhe në provat e lartcekura përkatësisht në diploma dhe kontrata e punës me të cilën paditësja është e punësuar si mësimdhënëse e shkollës SHFMU "Emin Duraku" në Gjakovë prej datës..., Aktvendimi mbi licencën më numër... me të cilën vërtetohet rrethana se paditësja posedon licencën e mësimdhënësës të vlefshme nga data 26 dhjetor 2012 deri me 26 dhjetor 2017, ashtu që hyrja në fuqi e Kontratës së Arsimit nga datë 18 prill 2017 deri me datën 22 janar 2021 ka qenë në fuqi dhe të njëjtës i takon e drejta për një kompensim të tillë, po ashtu edhe sipas udhëzimit administrativ nr.5/2017 neni 33 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ka parapare se "Vazhdoen për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014. Licencat e lëshuara në këto vite mbeten të vlefshme deri në periudhën e realizimit të VPM", që do të thotë se këtu paditësës i është vazhduar licenca e mësimdhënësit edhe për pesë vite.

Bazuar në listat e pagave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se paditësja ka realizuar pagën bazë 421.00 euro për periudhën për të cilën kërkohet kompensimi e që duke llogaritur me 27% e që del të jetë shuma prej 113.67euro nga duhet zbritur shtesën 58.32 euro që ka realizuar, e që ka mbetur pa u realizuar shuma prej 55.35 euro për 26 muaj, pra $55.35 \times 26 = 1,439.10$ euro, për çka Gjykata vendosi si në dispozitivin të këtij Aktgjykimi.

Neni 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës parasheh se i punësuar i ka të drejtën në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit çka rezulton se e paditura nuk i është përmbajtur Kontratës së punës dhe akteve administrative të cilat janë të zbatueshme që rezulton me pagesën e detyrimit paditësës.

Sipas nenit 8 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (LMD) është paraparë se "Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij". Dispozita e nenit 245 paragrafi 1 i LMD-së ka paraparë se: "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtje e tij", prej nga rezulton se debitori këtu e paditura është e detyruar që kreditorit, këtu paditësës të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë së aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me kamatën Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të LMD-së, ku parashihet se: "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor dhe kamatën. Paragrafi 2 i këtij neni parasheh se "Lartësia e kamatë

vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Paditësit i takon edhe kamata e gjykuar sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK-së, nuk ka vendosur lidhur me kompensimin e diferencës në pagë për periudhën nga 01 janar 2015 e deri më 14 shtator 2018 ngase i autorizuari i paditëses gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 25 korrik 2022 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe periudhën 01 janar 2015 deri më 14 shtator 2018 nuk e ka përfshirë në precizimin e bërë, sepse e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës për periudhën në fjalë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA dhe atë për taksën gjyqësore për padi shumë prej 20.00 euro, për përpilim të padisë shumë prej 104.00 euro dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditëses në dy seancë në shumë prej 270.40 euro, në shumë të tërësishme prej 394.40 euro.

Gjykata gjatë procedurës bëri vlerësimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse në arsyetimin e Aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar si dhe aplikimin e të drejtës materiale në marrjen e vendimit si më lartë.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 1382/21, datë 19 shtator 2022

G j y q t a r j a
Afijete Sada Glllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.